UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektor
Prof. Dr. Marjan DEMA

Nr. Prot.: 2/271
Datë: 24/7/2017

Në bazë të nenit 28 të statutit të Universitetit të Prishtinës, në koordinim me sekretarin e përgjithshëm të UP-së, marr këtë

VENDIM

lidhur me shfrytëzimin e pushimit vjetor kolektiv për personelin akademik dhe administrativ të universitetit për vitin 2017

I. Pushimi vjetor për të gjithë personelin akademik dhe administrativ të Universitetit të Prishtinës do të shfrytëzohet nga data 27.7.2017 deri më 25.8.2017.

II. Kthimi në punë nga pushimi vjetor kolektiv do të bëhet me datë 28.8.2017.

III. Përjashtim nga paragrafi I i këtij vendimi, do të bëhet për personelin të cilëve sipas ligjit në fuqi, i'u takojnë më së shumti 18 ditë pune të pushimit vjetor.

IV. Personeli që i takon kategorisë si në paragrafin III të këtij vendim, pas shfrytëzimit të 18 ditëve të pushimit vjetor, do të rikthehen në vendet e tyre të punës.

V. Personeli administrativ që pjesërisht e ka shfrytëzuar pushimin vjetor të vitit 2017, pjesën e mbetur të pushimit mund ta shfrytëzojë vetëm për ditët që i takojnë sipas ligjit.

VI. Nëpunësi civil mund t'i bartë në vitin tjetër maksimalisht dymbëdhjetë (12) ditë pune të pushimit vjetor të pashfrytëzuar. Ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor mund të shfrytëzohen më së largu deri në gjysmën e parë të vitit të ardhshëm kalendarik.

VII. Sekretari i njësisë akademike përkatëse është i obliguar që të caktojë së paku një zyrtar të shërbimit të studentëve që të jetë i pranishëm në fakultet deri më datë 28.7.2017 në ora 16.00.

VIII. Zyrtari i shërbimit të studentëve në njësinë akademike përkatëse i caktuar nga sekretari, sipas kërkesave do të ofrojë shërbime për tërheqjen e dokumenteve nga kandidatët të cilët nuk kanë arritur që të pranohen në afatin e parë të konkursit.

IX. Sekretari i njësisë akademike përkatëse, është i obliguar që për secilin nëpunës administrativ të lëshojë vendim individual për periudhën e shfrytëzimit të pushimit vjetor për vitin 2017.

X. Menaxheri i personelit, obligohet që për secilin nëpunës administrativ të AQ të lëshojë vendim individual për periudhën e shfrytëzimit të pushimit vjetor për vitin 2017.

XI. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Vendimi i'u dërgohet:

1. Menaxhmentit të UP-së;
2. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së;
3. Dekanëve të njësive akademike;
4. Sekretarëve të njësive akademike;
5. Drejtorëve të shërbimeve në AQ;
6. Menaxherit të personelit të UP-së;

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA" · UNIVERSITY OF PRISHTINA · 1970

Prof.dr. Marjan Dema

Rektor i UP-së